



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Rregulla ZRRE/Nr.01/2023**

# **RREGULLA PËR SISTEMIN E MBYLLUR TË SHPËRNDARJES**

**Prishtinë, 05 korrik 2023**

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në pajtim me Nenin 9 par. 1 nënpar. 1.7, Nenin 25 Nenin 26, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1, Nenit 41 par. 1 dhe 4 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, dhe Nenin 30 par. 1. të Ligjit për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085, në seancën e mbajtur më 05 korrik 2023 miratoi:

## **RREGULLËN PËR SISTEMIN E MBYLLUR TË SHPËRNDARJES**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulle është përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për t'u implementuar Sistemi i Mbyllur i Shpërndarjes (SMSH), përkatësisht përcaktimi i procedurave të aplikimit dhe licencimin të Operatorit të Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes, si dhe të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e operatorit dhe konsumatorëve të Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes.

#### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi**

1. Rregulla për Sistemin e Mbyllur të Shpërndarjes përcakton:
  - 1.1. Kriteret dhe kushtet për licencimin e Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes;
  - 1.2. Procedurën e aplikimit për t'u licencuar si Operator i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes;
  - 1.3. Procedurën e licencimit të Operatorit për të operuar me Sistemin e Mbyllur të Shpërndarjes, duke përfshirë përkufizimin e aktiviteteve që do të kryhen nga SMSH-ja;
  - 1.4. Raportet ndërmjet Operatorit të Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes, operatorëve të sistemit (transmissionit ose distributionit) dhe konsumatorëve; dhe
  - 1.5. Raportimin rregullativ dhe monitorimi i performancës së operatorëve të Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes.

Neni 3  
**Përkufizimet**

1. Termat e përdorur në këtë Rregull kanë kuptimin e mëposhtëm:
  - 1.1. **Shërbimet ndihmëse** – të gjitha shërbimet e nevojshme për funksionimin e një sistemi të transmetimit ose të sistemit të shpërndarjes.
  - 1.2. **Përgjegjësia për balancim** - detyrimi i pjesëmarrësit të tregut për të balancuar prodhimin, konsumin, blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike në përputhje me oraret e pranuar dhe të jetë financiarisht përgjegjës për shlyerjen e jobalancave.
  - 1.3. **Pala përgjegjëse për balanc** – pjesëmarrësi i tregut ose përfaqësuesi i tij i zgjedhur përgjegjës për shlyerjen e jobalancave të tij.
  - 1.4. **Sistemi i Mbyllur i Shpërndarjes ose SMSH** – një sistem që shpërndan energjinë elektrike, brenda një zone të caktuar gjeografike, në të cilën janë të përqendruara shërbimet industriale, tregtare ose të përbashkëta, por pa përfshirë konsumatorët familjarë, nëse:
    - 1.4.1 për arsye specifike teknike ose të sigurisë, operacionet ose procesi i prodhimit të shfrytëzuesve të atij sistemi janë të integruara; dhe
    - 1.4.2 ai sistem shpërndan energjinë elektrike kryesisht te pronari ose operatori i sistemit ose ndërmarrjet e tyre përcjellëse.
  - 1.5 **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)** – person fizik ose juridik, i licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për kryerjen e aktiviteteve të shpërndarjes të energjisë elektrike në nivel vendi, përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar dhe, sipas rastit, interkoneksionet e tij me sistemet tjera dhe për sigurimin afatgjatë të aftësisë së sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike.
  - 1.6 **Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)** – agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
  - 1.7 **Sistemi** - një sistem i pajisjeve të lidhura të destinuar për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike ose termike.
  - 1.8 **Përdorues i Sistemit** - person fizik ose juridik që furnizon, ose furnizohet nga, një sistem transmetimi ose i shpërndarjes.
  - 1.9 **Furnizuesi** – një ndërmarrje energjetike e licencuar për të kryer aktivitete të furnizimit me energji elektrike.

- 1.10 **Sistemi i transmisionit** - sistemi që përfshin një kombinim të linjave të tensionit të lartë, nënstacioneve dhe objekteve që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike.
- 2 Çdo term që nuk është përdorur në këtë Rregull kduhet të interpretohet në pajtim me Ligjin (Nr. 05/L-084) për Rregullatorin e Energjisë, Ligji (Nr. 05/L-081) për Energjinë, Ligji(Nr. 05/L-085) për Energjinë Elektrike, dhe ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

## **KAPITULLI II SISTEMI I MBYLLUR I SHPËRNDARJES**

### Neni 4

#### **Kushtet për t'u konsideruar një sistem i shpërndarjes Sistem i Mbyllur i Shpërndarjes**

1. Që një zonë e lidhur në sistemit e Operatorit të Shpërndarjes të konsiderohet SMSH, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - 1.1. Shpërndan energjinë elektrike brenda një zone gjeografikisht të kufizuar industriale, tregtare ose shërbime të përbashkëta, nëse:
    - 1.1.1. për arsye specifike teknike ose të sigurisë, operacionet ose procesi i prodhimit nga shfrytëzuesit e atij sistemi janë të integruara;
    - 1.1.2. ai sistem shpërndan energjinë elektrike kryesisht te pronari ose operatori i sistemit ose ndërmarrjet vartëse, dhe
    - 1.1.3. pa paragjykuar Nenin 3, nënpar. 1.63 të Ligjit (Nr. 05/L-085) për Energjinë Elektrike shpërndan energji elektrike te një numër i vogël i familjeve apo asociacioneve të ngjashme me të punësuar tek pronari i sistemit të distribucionit (SMSH) dhe të vendosur në zonën e shërbimit të sistemit të mbyllur të shpërndarjes.
  - 1.2. Konsumi vjetor i energjisë elektrike i konsumatorëve familjar që ndodhen brenda zonës së shërbyer nga SMSH-ja, nuk duhet të kalojë vlerën prej **10%** krahasuar me konsumin e përgjithshëm vjetor të energjisë elektrike të të gjithë shfrytëzuesve në SMSH. ZRRE do të caktojë vlerën e konsumit maksimal të amvisërive për secilin aplikues në veçanti.
  - 1.3. Ka një titullar (pronar) të veçantë të atij sistemi të shpërndarjes.
  - 1.4. Është i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, përfshire aktivitetet e shpërndarjes së energjisë elektrike.
  - 1.5. Ka një projekt teknik të instalimeve, duke përfshirë linjat, transformatorët, lidhjet dhe pikat matëse.
  - 1.6. Ka një hartë gjeografike të infrastrukturës me vizatime të infrastrukturës së SMSH-së, nga e cila kuptohet shprehimisht se është një zonë gjeografikisht e kufizuar.

- 1.7. Pajisjet e sistemit të shpërndarjes ndërtohen dhe instalohen në përputhje me ligjin për Energji Elektrike, kodet teknike të operatorëve të sistemeve dhe në përputhje me afatet dhe kushtet dhe kërkesat e përcaktuara me rregulloret teknike përkatëse.
- 1.8. Ka një marrëveshje për kyçje me një operator të sistemit të shpërndarjes ose transmetimit.
- 1.9. Ka pikën e vet të kyçjes dhe matjes (pika e leximi për faturim), siç përcaktohet në marrëveshjen për kyçje me OSSH-në ose OST-në.
- 1.10. Ka një listë të shfrytëzuesve të SMSH-së me numrin e tyre të identifikimit të pikës së kyçjes.
- 1.11. Çdo shfrytëzues fundor (konsumator fundor) i SMSH-së ka njehsorin e vet.
- 1.12. Asetet e shpërndarjes të zonës së mbuluar të sistemit janë në pronësi të personit që aplikon për të marrë licencën për operimin e SMSH-së.
- 1.13. Ka personel të kualifikuar për të operuar dhe mirëmbajtur objektet, instalimet, pajisjet dhe impiantet e shpërndarjes, ose ka kontratë me operator të kualifikuar për të operuar SMSH-në.
- 1.14. Ka një llogari të veçantë për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në sistemin e mbyllur, e ndarë nga aktivitetet e tjera të biznesit.

#### Neni 5

#### **Licencimi për operim me Sistemin e Mbyllur të Shpërndarjes**

1. Çdo person fizik ose juridik që plotëson kushtet e përcaktuara në Nenin 4 të kësaj Rregulle mund të aplikojë në ZRRE për tu pajisur me Licencë për të operuar me SMSH-në.
2. Aplikacioni për licencë për të operuar me SMSH do të dorëzohet me shkrim dhe në formën e specifikuar në Shtojcën 1 të kësaj Rregulle.

### **KAPITULLI III**

#### **PROCEDURA PËR LICENCIMIN E OPERATORIT të SMSH-ve**

#### Neni 6

#### **Aplikim për licencë për operimin e SMSH-së**

1. Nëse aplikuesi i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregulle, atëher mund të aplikoi për licencë për operimin e SMSH-së duke plotësuar aplikacionin sipas Shtojcës 1 të kësaj Rregulle.
2. Aplikuesi mund të aplikojë për të operuar vetë SMSH-në nëse ka resurset e nevojshme, mjete financiare të disponueshme dhe personelin e kualifikuar, ose ai mund të kontraktojë operimin e SMSH-

së përmes palës së tretë e cili do të veprojë në emër të të licencuarit, me kusht që kjo palë e tretë të jetë e kualifikuar për kryerjen e shërbimeve të operimit të SMSH-së.

3. Procedurat e aplikimit për licencimin e aktiviteteve të operimit të SMSH-së do të jenë në përputhje me Nenin 8 (Kushtet e Përgjithshme për Aplikim) paragrafët 1 dhe 2 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe Nenin 12 (Kushtet specifike për Aplikim për Licencë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) të të njëjtit Rregull.

#### Neni 7

##### **Lëshimi i licencës së funksionimit të SMSH-së**

1. Për Licencim të Operatorit të SMSH-së, Neni 28, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë aplikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë.
2. ZRRE i lëshon licencën e operimit të SMSH-së pronarit të SMSH-së.

#### Neni 8

##### **Afatet dhe kushtet e përgjithshme për licencën e Operatorit të SMSH-së**

1. Në bazë të Nenit 15 paragrafit 2 të Rregullës për Licencim, Licenca e Operatorit të SMSH-së përfshinë afatet dhe kushtet e përgjithshme të zbatueshme si në vijim:
  - 1.1 baza ligjore për dhënien e licencës;
  - 1.2 llojin e aktivitetit të licencuar energjetik;
  - 1.3 përkufizimet;
  - 1.4 realizimi i aktivitetit të licencuar;
  - 1.5 territorin e mbuluar nga licenca;
  - 1.6 pronësinë ose të drejtën ligjore për të përdorur objektin dhe pjesët përbërëse të sistemit;
  - 1.7 objektet kryesore që përdoren për të kryer veprimtarinë e licencuar;
  - 1.8 afatet, kushtet, të drejtat dhe detyrimet e të licencuarve;
  - 1.9 kushti për të respektuar të gjitha kodet përkatëse teknike dhe komerciale duke përfshirë rregullat e tregut;
  - 1.10 dispozitat lidhur me kontabilitetin;
  - 1.11 dispozitat që kanë të bëjnë me ndalimin e ndërsuvencioneve (mbisuvencioneve);
  - 1.12 ndalimi i sjelljeve të papajtueshme;
  - 1.13 ndalimi i diskriminimit të Përdoruesve të Sistemit;
  - 1.14 qëndrueshmëria financiare e të licencuarit;
  - 1.15 kushti për respektimin e standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit;
  - 1.16 dispozitat në lidhje me ndryshimin në kontrollin e të licencuarit;
  - 1.17 ndalimi i ndarjes së aseteve pa miratimin e ZRRE-së;

- 1.18 detyrimin për të ruajtur të dhënat në lidhje me aktivitetin e të licencuar sipas nevojës;
- 1.19 detyrimi për të ofruar qasje në asete për operatorët e sistemit;
- 1.20 dispozitat në lidhje me raportimin në ZRRE;
- 1.21 dispozita për pagesën e tarifave;
- 1.22 dispozita në lidhje me procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe ankesës;
- 1.23 pasojat juridike të shkeljes së dispozitave të licencës etj.

#### Neni 9

#### **Afatet dhe kushtet specifike për funksionimin e SMSH-së**

1. Licenca e Operatorit të SMSH-së, duhet të përfshijë termat dhe kushtet specifike të zbatueshme të specifikuara në Nenin 16, par. 3 të Rregullës (ZRRE/Nr.07/2017) për Licencim e Aktiviteteve Energjetike në Kosovë, si më poshtë:
  - 1.1 kushtin për të ofruar kyçjen dhe shfrytëzimin e SMSH-së për palët e treta në mënyrë objektive dhe jodiskriminuese;
  - 1.2 dispozitat adekuate që rregullojnë dorëzimin e kërkesave për qasje, procedurën për refuzimin e qasjes dhe procedurën për ankesë nga palët të cilave iu refuzohet qasja;
  - 1.3 detyrimin për të informuar dhe përditësuar për çdo plan zhvillimi apo investimi brenda fushës së shërbimeve;
  - 1.4 detyrimi për të mbajtur një databazë të informatave të marrë nga përdoruesit e SMSH-së, duke mbajtur të dhëna të disponueshme për publikun në baza të përmbledhura, duke ruajtur informacionin që konsiderohet konfidencial dhe komercialisht i ndjeshëm;
  - 1.5 të gjitha kushtet e matjes dhe faturimit janë projektuar dhe kryer në mënyrë të sigurt dhe ekonomike për të siguruar që përdoruesit e sistemit dhe klientët e lidhur në sistem janë në gjendje të marrin të dhëna të përditësuara dhe të përshtatshme për konsumin dhe kërkesën;
  - 1.6 reduktimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes; dhe
  - 1.7 instalimin e një sistemi matës të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm, për t'i mundësuar operatorit të ofrojë informacion të saktë për OST-në, OSSH-në, ZRRE-në, përdoruesit e sistemit ose palëve të tjera të interesuara.

#### Neni 10

#### **Kohëzgjatja e Licencës për operimin e SMSH-së**

Kohëzgjatja e Licencës për operimin e SMSH-së, do të jetë në përputhje me Ligjet dhe Rregullën për licencimin e aktiviteteve në sektorin e energjisë.

#### Neni 11

### **Ndërprerja e Licencës për operimin e SMSH-së**

Nëse Licenca e SMSH-së, ndërpritet sipas Nenit 37, paragrafi 2 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE do të caktoj një subjekt tjetër që plotëson kriteret për t'u Licencuar si SMSH, i cili do të kryejë aktivitetet e SMSH-së, për një periudhë të caktuar kohore.

#### Neni 12

### **Bankrotimi i pronarit të SMSH-së**

Në rast se bankroton pronari i SMSH i/e cili/a është edhe titullar i licencës për operimin e SMSH-së, atëherë ZRRE do të veprojë në pajtim me Nenin 53 (procedura në rast bankrotimi) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

#### Neni 13

### **Prodhimi i energjisë elektrike brenda zonës së mbuluar nga SMSH-ja**

Shfrytëzuesit e SMSH-së dhe pronari i SMSH-së mund të prodhojnë energji për shitje apo për vetë-konsum duke aplikuar legjislacionin në fuqi dhe rregullat përkatëse të aprovuara nga ZRRE dhe kodet teknike.

#### Neni 14

### **Lirimet për Sistemet e Mbyllura të Shpërndarjes**

1. ZRRE mund të lirojë Operatorin e SMSH-së nga ndonjë obligim të cilat do të përbënin një barrë administrative të panevojshme për shkak të natyrës së veçantë të marrëdhënies ndërmjet operatorit të SMSH-së, dhe përdoruesve të sistemit.
2. Me kërkesë të të licencuarit të SMSH-së, dhe në bazë të nenit 30 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe nenit 41 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE mund të lirojë Operatorin e Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes nga:
  - 2.1. obligimi për të blerë energjinë e përdorur për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe kapaciteteve rezervë në sistemin e tij, mbi bazën e procedurave transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg;
  - 2.2. obligimin që çmimet, përkatësisht kompensimet apo metodologjitë në të cilat bazohet përlllogaritja e tyre, të miratohen nga Rregullatori para hyrjes së tyre në fuqi.
3. Në rast se preket ndonjë lirim nga obligimet, siç përcaktohet në paragrafin 2. të këtij neni, çmimet ekzistuese përkatësisht kompensimi ose metodologjitë në të cilat bazohen llogaritjet, mund të



rishikohen dhe përshtaten me metodologjinë e çmimeve të miratuar nga ZRRE, me kërkesa të shfrytëzuesve të rrjeteve të tilla.

4. Përdorimi i rastësishëm i SMSH-së nga një numër i vogël i amvisërive me punësim në atë zonë, ose shoqata të ngjashme me pronarin e sistemit të shpërndarjes dhe që ndodhen brenda zonës që shërbehet nga SMSH nuk e pengon lirin nga paragrafi 2. i këtij neni.

## **KAPITULLI IV DETYRIMET DHE MARRËDHËNIET E OPERATORIT TË SHMSH ME OPERATORËT E SISTEMIT, KONSUMATORËT**

### Neni 15

#### **Marrëdhëniet me operatorët e sistemit të OST-së dhe OSSH-së**

1. SMSH duhet të ketë Marrëveshje të Kyçjes me OST-në ose OSSH-në dhe Kontratë për Shërbim (përdorim të sistemit) me OST-në ose OSSH-në.
2. OST-ja ose OSSH-ja janë të obliguara të sigurojë nivelin e tensionit në pikën e kyçjes me SMSH-në, në përputhje me rregullat dhe rregulloret, Kodin e Transmetimit/Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes për kapacitetin e kërkuar nga SMSH-ja.
3. Energjia e shfrytëzuar në sistemin e mbyllur matet duke përdorur pajisje matëse në pronësi të OST-së ose OSSH-në me të cilin është kyçur sistemi i mbyllur dhe nuk duhet të tejkaloi kapacitete e kërkuar sipas marrëveshjes për kyçje.
4. Operatori i SMSH-së duhet të harmonizojë operacionet e tij me ato të OST-së ose OSSH-së me të cilën është i kyçur.
5. Operatori i SMSH-së duhet t'u përmbahet rregullave të rrjetit të operatorëve të sistemit OST-së dhe OSSH-së.
6. SMSH-ja do të sigurojë funksionimin e sigurt dhe të besueshëm të OSSH-së dhe do të njoftojë menjëherë OST-në ose OSSH-në për çdo vështirësi teknike në funksionimin e SMSH-së. OST dhe OSSH nuk janë përgjegjëse problemet e mundshme teknike mbrenda SMSH, përkatësisht pas pikës matëse.

Neni 16  
**Pjesëmarrja në treg nga SMSH-ja**

1. Në përputhje me Nenin 24 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i SMSH-së është pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike vetëm për mbulimin e humbjeve në rrjetin e mbyllur të shpërndarjes dhe blerjet e shërbimeve ndihmëse që nuk kanë të bëjnë me frekuencën.
2. Operatori i SMSH-së do të sigurojë energji elektrike sipas afateve dhe kushteve të tregut për të mbuluar humbjet në sistemin e mbyllur të shpërndarjes.
3. Operatori i SMSH-së është përgjegjës për jobalancet si çdo pjesëmarrës tjetër në tregun e energjisë elektrike.

Neni 17  
**Obligimet e operatorit për shfrytëzuesit e SMSH-së**

1. Operatori i SMSH-ve është përgjegjës për sigurimin e shpërndarjes së vazhdueshme, të sigurt dhe të besueshme të energjisë elektrike për shfrytëzuesit e tij në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente, si dhe për të siguruar kërkesat/standardet e cilësisë së shërbimit.
2. Ofrimi për shfrytëzuesit i informacionit përkatës dhe në kohë që kërkohet për kyçjen dhe qasjen në SMSH.
3. SMSH siguron kyçjen e shfrytëzuesit në pikën ekonomisht dhe teknikisht më optimale, si dhe qasjen e palëve të treta në sistemin e mbyllur.
4. Përgjegjës për shërbimet e matjes për konsumatorët brenda SMSH-së, dhe leximin e njehsorëve është Operatori i SMSH-së.
5. Publikimi i procedurave të ankesave për shfrytëzuesit, si dhe procedurat e trajtimit të ankesave të SMSH-së.
6. Publikimi i planit të mirëmbajtjes së sistemit në faqen e tij të internetit në përputhje me rregullat e operimit të sistemit të mbyllur.
7. Siguron qasje elektronike në listën e konsumatorëve të kyçur me sistemin e mbyllur, së bashku me konsumin, ngarkesën dhe të dhëna të tjera përkatëse për interesin e furnizuesve.
8. Bën të disponueshëm qasjen në pajisjet matëse që zotëron.
9. Publikimi i tarifave për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike që ofron.

10. Publikimi i të gjitha kompensimeve për çdo kategori të konsumatorëve që është i kyçur me sistemin e mbyllur.
11. Mbajtja e librave të dispeçerëve, regjistrave të besueshmërisë së sistemit të komunikimit, të dhënave nga të dhënat matëse të sistemit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit, dhe të dhënave, librave dhe regjistrave që operatori ruan siç kërkohet me rregulloren për ruajtjen e të dhënave.
12. Në rast se kërkesa e një aplikuesi të ri për kyçje në SMSH-së e tajkalon kapacitetin e lejuar të SMSH-së (kapaciteti total i konsumatorëve egzistues+kapaciteti i konsumatorit të ri), atëher SMSH duhet të riaplikoj për kapacitet shtesë të OST dhe OSSh.

#### Neni 18

##### **Shfrytëzuesit e SMSH-së**

1. Konsumatorët e SMSH-së kanë të drejtë të ndërrojnë furnizuesin e tyre.
2. Në rast falimentimi (ose mospërmbushje tjetër) të furnizuesit, klientët e SMSH-së do të furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit.
3. Konsumatori i SMSH-së mund të paraqesë një ankesë tek Operatori i SMSH-së.
4. Nëse një konsumator i SMSH-së është i pakënaqur me përgjigjen e Operatorit të SMSH-së lidhur me ankesën e tij, ankesa i dorëzohet ZRRE-së.

#### Neni 19

##### **Monitorimi nga ZRRE-ja**

ZRRE-ja do të monitorojë performancën dhe pajtueshmërinë e SMSH-së me kushtet e licencës në përputhje me Nenin 17 dhe Nenin 18 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

#### Neni 20

##### **Vazhdimi, ndryshimi, pezullimi, transferimi dhe shkëputja e licencës për operim të SMSH-së**

ZRRE mund të zgjasë, ndryshojë, pezullojë, transferojë dhe shkëpus licencën e SMSH-së, bazuar në dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

**KAPITULLI V**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE**

**Neni 21**  
**Gjuha zyrtare**

Kjo Rregull publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

**Neni 22**  
**Ndryshim/plotësimi**

1. ZRRE ka të drejtë të ndryshojë ose plotësoj çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedurat për ndryshimin ose plotësimin e kësaj Rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

**Neni 23**  
**Interpretimi**

Në rast se ka paqartësi në lidhje me dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi i ZRRE-së, do të nxjerrë interpretime sqaruese.

**Neni 24**  
**Hyrja në fuqi**

1. Rregulla hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.
2. Rregulla publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


**Bordi i ZRRE-së:**



Ymer Fejzullahu, Kryesues



Lutfije Dervishi, Anëtar



Gani Buçaj, Anëtar

## Shtojca 1

### APLIKACION PËR LICENCIM TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NË SISTEMIN E MBYLLUR TË SHPËRNDARJES

<b>I</b>	<b>APLIKUESI APLIKON PËR:</b> (shëno me plus njërin nga aktivitetet e mëposhtme, ose me PZ ato që nuk janë të zbatueshme)
	LICENCË PËR SHPËRNDARJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE
	VAZHDIM I LICENCËS PËR SHPËRNDARJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE
	TRANSFER I LICENCËS PËR SHPËRNDARJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

<b>II</b>	<b>UDHËZIME PËR APLIKIM</b>
<p>Aplikuesi duhet të dorëzojë në Zyrën e Rregullatorit për Energji këtë aplikacion të plotësuar dhe dëshmitë e bashkëngjitura origjinale apo të noterizuara si dhe kopje elektronike (nëse kërkohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji), në njërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë.</p> <p>Aplikuesi do të dorëzojë aplikacionin e kompletuar në këto adresa:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▲ Në formë të shkruar në: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rruga: Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës</li><li>▲ Në formë elektronike në: <a href="mailto:legal-licensing@ero-ks.org">legal-licensing@ero-ks.org</a></li></ul> <p>Për çdo ndryshim të të dhënave të ndërmarrjes apo personit kontaktues, për aq kohë sa licenca është e vlefshme, duhet të njoftohet Zyra e Rregullatorit për Energji.</p>	
<b>EMRI I NDËRMARRJES (PERSONIT JURIDIK):</b>	<b>VULA:</b>

III INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI NDËRMARRJEN & PERSONIN KONTAKTUES	
<b>EMRI I NDËRMARRJES (PERSONIT JURIDIK):</b>	
SELIA:	
ADRESA:	
NR. I REGJISTRIMIT TË BIZNESIT:	
NR. I TELEFONIT:	NR. I FAKSIT:
ADRESA E E-MAIL-IT:	
<b>EMRI DHE MBIEMRI I PERSONIT KONTAKTUES:</b>	
ADRESA:	
NR. I TELEFONIT:	NR. I FAKSIT:
ADRESA E E-MAIL-IT:	
<b>AKTIVITETET AKTUALE TË APLIKUESIT NË LËMIN E ENERGJISË NË KOSOVË:</b>	
1.	
2.	
<b>AKTIVITETET E MËPARSHME TË APLIKUESIT NË LËMIN E ENERGJISË NË KOSOVË:</b>	
1.	
2.	

IV DËSHMITË QË DUHET TË BASHKËNGJITEN ME KËTË APLIKACION		
<i>Udhëzim: Shëno me plus (në të djathtë) për dokumentet e bashkëngjitura këtij aplikacioni:</i>		
Nr.	DËSHMI/DOKUMENT (ORIGINAL OSE NOTERIZUAR)	BASHKËNGJITUR (SHËNO ME PLUS)
1.	Kopjen e Certifikatës së regjistrimit, të lëshuar nga agjencia për regjistrimin e bizneseve në Kosovë, duke përfshirë edhe aktivitetin për shpërndarjen e energjisë elektrike.	

<b>2.</b>	Statutin e ndërmarrjes apo marrëveshjen e krijimit të shoqërisë.	
<b>3.</b>	Planin afarist (të biznesit) të aplikuesit lidhur me aktivitetet energjetike që do të mbulohen nga licenca, që mbulon së paku tre (3) vitet e ardhshme.	
<b>4.</b>	Dëshmi mbi aftësinë financiare, të aplikuesit dhe/apo të kompanisë amë që konfirmojnë disponueshmërinë (ekzistencën) e fondeve për aktivitetin e energjisë të paktën dhjetë (10%) të vlerës të vlerës vjetore të kostos së operimit. Kjo dëshmi duhet të mbështetet me dëshmi bankare të lëshuar nga Banka jo më herët se pesë (5) ditë prej datës së aplikimit.	
<b>5.</b>	Pasqyrat financiare vjetore të aplikuesit apo ndërmarrjes ëmë për tre (3) vitet e fundit. Këto pasqyra financiare duhet të jenë të audituara nga auditorë të licencuar dhe të pavarur financiarë.  Ndërmarrjet e sapokrijuara duhet të dorëzojnë një deklaratë mbi gjendjen financiare aktuale.	
<b>6.</b>	Dëshmi për hapjen dhe mbajtjen e llogarisë së veçantë për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në zonën e mbyllur të shpërndarjes.	
<b>7.</b>	Certifikatën nga organi kompetent që aplikuesi i përmbush detyrimet ligjore lidhur me pagimin e taksave.	
<b>8.</b>	Certifikatën nga organi kompetent që aplikuesi nuk është në procedurë likuidimi ose falimentimi.	
<b>9.</b>	Përshkrimin e përvojës së aplikuesit për kryerjen e aktiviteteve të energjisë, që nga themelimi e deri në momentin e aplikimit (biografinë e ndërmarrjes).	
<b>10.</b>	Informacione në lidhje me strukturën organizative (menaxhmentin dhe personelin profesional) të aplikuesit, në veçanti strukturën e njësisë që do të merret me aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.	
<b>11.</b>	Dëshmi mbi personelin e kualifikuar për operimin e sistemit të shpërndarjes, përfshirë biografitë-CV <sup>të</sup> e stafit që do të merret me aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.	
<b>12.</b>	Nëse pronari i SMSH-së e ka kontraktuar shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike te një operator i kualifikuar tjetër, atëher dëshmitë për aftësinë dhe personelin profesional të kompanisë së kontraktuar.	
<b>13.</b>	Dëshmi lidhur me pronësinë ose të drejtën ligjore për përdorimin e elementeve në sistemin e mbyllur të shpërndarjes.	

14.	Një përshkrim të karakteristikave përkatëse të sistemit të mbyllur të shpërndarjes, bashkë me karakteristikat e tyre teknike dhe territorin për shpërndarjen e energjisë elektrike.	
15.	Një hartë gjeografike të infrastrukturës me vizatime të infrastrukturës së SMSH-së, nga e cila shprehimisht definohet se është një zonë gjeografikisht e kufizuar.	
16.	Projektin teknik të instalimeve, duke përfshirë linjat, transformatorët, lidhjet dhe pikat matëse.	
17.	Specifikimet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve matëse të sistemit të mbyllur të shpërndarjes	
18.	Dëshminë se ka një marrëveshje për kyçje me një operator të sistemit të shpërndarjes ose transmetimit.	
19.	Dëshminë për pikën e vet të kyçjes dhe matjes (pika e leximit për faturim), siç përcaktohet në marrëveshjen për kyçje me OSSH-në ose OST-në.	
20.	Dëshminë për listën e shfrytëzuesve të SMSH-së me numrin e tyre të identifikimit të pikës së kyçjes.	
21.	Dëshmitë mbi karakteristikat sa i përket energjisë elektrike të shfrytëzuesve të SMSH-së, përfshirë konsumin vjetor të secilit shfrytëzues.	
22.	Numrin e konsumatorëve familjar (nëse ka) që janë të vendosur në zonën e sistemit të mbyllur të shpërndarjes.	
23.	Konsumin total vjetor të konsumatorëve familjar mbrenda sistemit të mbyllur të shpërndarjes.	
24.	Dëshminë se çdo shfrytëzues i SMSH-së ka njehsorin e vet.	
25.	Dëshminë mbi konsumin vjetor të tërë sistemit të mbyllur të shpërndarjes.	
26.	Dëshmi lidhur me numrin e pritur dhe strukturën e konsumatorëve të kyçur dhe atyre potencial.	
27.	Treguesit për matjen e cilësisë së furnizimit me energji (kohëzgjatjen, frekuencat, numrin e ndërprerjeve, ndërprerjet e shprehura në minuta për konsumator etj.) dhe shërbimet në operimin e sistemit (informatat e përgjithshme, marrëveshjet për leximin e njehsorëve, kohën e kyçjes, dështimet, rivendosjen e sistemit energjetik pas dështimeve etj).	



<b>28.</b>	Dëshmi për pagesën e taksës fillestare të aplikimit për licencim, në shumë prej njëmijë euro (1,000.00 €), për rishikim-modifikim/ndryshim apo vazhdim, si dhe transfer licence në shumë prej pesëqind (500.00 €), në pajtim me Nenin 4 Rregullës për Licencim dhe Shtojcën 1 të Rregullës për Taksat.	
------------	--	--

<b>V DEKLARIMI I APLIKUESIT</b>			
<i><b>Udhëzim:</b> Përgjigjuni me “PO” ose “JO” në deklaratat si në vijim.</i>			
NR.	DEKLARATAT:	PO	JO
1.	A janë dënuar apo ndjekur penalisht për vepra penale menaxherët e aplikuesit?		
2.	A është tërhequr Licenca e aplikuesit për aktivitetin për të cilin aplikon, brenda pesë (5) vjetëve që nga data kur është dorëzuar aplikacioni?		
3.	A ka vepruar dhe a do të veprojë aplikuesi (në Kosovë apo jashtë saj) në pajtim me të gjitha dispozitat e legjislacionit në fuqi, lidhur me mbrojtjen e mjedisit?		
4.	A i kupton aplikuesi dhe a është i vetëdijshëm për obligimet e tij që të zbatojë legjislacionin për sektorin e energjisë, rregullat e nxjerra nga Rregullatori, kodet teknike dhe komerciale dhe legjislacionin tjetër në fuqi?		
5.	A ka bërë aplikuesi shkelje në Kosovë apo jashtë saj sa i përket kushteve të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë?		

## Deklaratë

Unë (personi përgjegjës): .....

(Emri & Mbiemri)

.....

(Pozita)

deklarojë se të gjitha informacionet, dëshmitë dhe dokumentet e bashkëngjitura në këtë Aplikacion për aq sa jam në dijeni janë origjinale dhe të sakta dhe i nënshtrohem dënimit për dëshmi të rreme dhe dhënien e informacionit të rremë.

**DATA:** \_\_\_\_\_

**VENDI:** \_\_\_\_\_

**NËNSHKRIMI:** \_\_\_\_\_

**VULA:**